ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 201/11600-26-9438-2-1-1

Sa i përket tenderit për *"Mirëmbajtja, mbështetja dhe avancimi i platformës së Fiskalizimit Digjital B2C sipas kërkesave të AK-së"*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	PBC SH.P.K.
NUI	810845985
Adresa	Rruga Bekim Fehmiu, 91
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044467467
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bashkim Selmani
Adresa elektronike	bs@pbc.group
Data e parashtrimit të ankesës	26.11.2026

Vulosur nga: PBC SH.P.K.
Data: 26.11.2026 13:30:24
Lëshuesi: rTrust Issuing CA
ID: 6GCD-KABF-S8PS-YJ59-RNVS

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:
Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:
Ankesa i përket grupeve:

"Mirëmbajtja, mbështetja dhe avancimi i platformës së Fiskalizimit Digjital B2C sipas kërkesave të AK-së

- Njoftimi për kontratë: 28.10.2026
- Letër standarde e kërkesës për informata sqaruese: 05.11.2026
- Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara:

- 10.11.2026
- Letër standarde e kërkesës për informata sqaruese: 10.11.2026
- Kërkesa për rishqyrtim: 12.11.2026
- Vendimi për pezullimin e aktivitetit të prokurimit pas paraqitjes së kërkesës për
- rishqyrtim: 14.11.2026
- Vendimi i AK-së për refuzimin e trajtimit të kërkesës për rishqyrtim: 16.11.2026
- B58 – Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të
- prokurimit: 16.11.2026
- B10 – Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, i publikuar në platformën e-
- Prokurimi: 18.11.2026
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: 23.11.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

PBC , në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, më datë 12.11.2026 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues – Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), duke paraqitur tetë pretendime ankimore.

Kërkesa për rishqyrtim është parashtruar gjashtë ditë kalendarike para afatit fillestar për dorëzimin e ofertave (18.11.2026, ora 13:30), duke respektuar afatet e përcaktuara në nenin 108/A.3.1 të LPP-së dhe nenin 60.1(a) të RRPP-së, edhe pa marrë parasysh zgjatjen e mëvonshme të afatit deri më 23.11.2026.

Autoriteti Kontraktues, përmes vendimit të datës 16.11.2026, ka refuzuar trajtimin e

kërkesës për rishqyrtim, pa shqyrtuar në përmbajtje pretendimet e parashtruara nga PBC.

Rrjedhimisht, PBC, në bazë të nenit 109 të LPP-së, më datë 25.11.2026 ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, brenda afatit ligjor prej dhjetë ditësh nga data e vendimit të Autoritetit Kontraktues, në përputhje me nenin 109 të LPP-së dhe nenin 64.1 të RRPP-së.

Objekt i kësaj ankese është kundërshtimi i vendimit për refuzimin e trajtimit të kërkesës për rishqyrtim, si dhe i anulimit të aktivitetit të prokurimit dhe veprimeve pasuese, në masën që ato përbëjnë bazën e këtij refuzimi dhe cenojnë të drejtën për mbrojtje juridike.

Të tetë pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim mbeten të pandryshuara, në përputhje me nenin 64.2 të RRPP-së.

Bashkëlidhur kësaj ankese paraqitet kopja e vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 16.11.2026, të nxjerrë në kuadër të procedurës paraprake për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas nenit 108/A të LPP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura lidhur me mosshqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim dhe anulimin e aktivitetit të prokurimit:

- Neni 108/A i LPP-së,
- Neni 62.1 i RRPP-së,
- Neni 62.2 i RRPP-së,
- Neni 63.1.1(b) i RRPP-së,
- Neni 61.1 i RRPP-së,
- Neni 62 i LPP-së,
- Neni 43.1 i RRPP-së,
- Neni 43.2 i RRPP-së,
- Neni 43.8(a) i RRPP-së,
- Neni 109 i LPP-së,
- Neni 10 i LPP-së.

Dispozitat e shkelura sipas pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të datës 12.11.2026, të cilat mbeten të pandryshuara:

- Neni 7 i LPP-së,
- Neni 9 i LPP-së,
- Neni 27 i LPP-së,
- Neni 28 i LPP-së,
- Neni 51 i LPP-së,
- Neni 52 i LPP-së,
- Neni 69 i LPP-së,
- Neni 17.12 i RRPP-së,
- Neni 19.1 i RRPP-së,
- Neni 19.4 i RRPP-së,
- Neni 25.5 i RRPP-së,
- Neni 25.6 i RRPP-së,
- Neni 25.17 i RRPP-së,
- Neni 26.9 i RRPP-së,
- Neni 27.7 i RRPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Objekti dhe pranueshmëria e ankesës

PBC, në bazë të nenit 109 të LPP-së, kundërshton vendimin e ATK-së të datës 16.11.2026 për refuzimin e trajtimit të kërkesës për rishqyrtim të datës 12.11.2026. Anulimi dhe veprimet pasuese kundërshtohen në masën që përbëjnë bazën e këtij refuzimi dhe cenojnë mbrojtjen juridike. Tetë pretendimet fillestare mbeten të pandryshuara, në pajtim me nenin 64.2 të RRPP-së.

Kërkesa fillestare është parashtruar gjashtë ditë kalendarike para afatit fillestar (18.11.2026, ora 13:30), duke respektuar nenin 108/A.3.1 të LPP-së dhe nenin 60.1(a) të RRPP-së, edhe pa llogaritur zgjatjen deri më 23.11.2026. Ankesa e datës 25.11.2026 është brenda dhjetë ditëve nga vendimi i datës **16.11.2026** (neni 109 i LPP-së dhe 64.1 i RRPP-së).

II. Kronologjia e dokumentuar

- Njoftimi për kontratë: 28.10.2026
- Letër standarde e kërkesës për informata sqaruese: 05.11.2026
- Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 10.11.2026
- Letër standarde e kërkesës për informata sqaruese: 10.11.2026
- Kërkesa për rishqyrtim: 12.11.2026
- Vendimi për pezullimin e aktivitetit të prokurimit pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim: 14.11.2026
- Vendimi i AK-së për refuzimin e trajtimit të kërkesës për rishqyrtim: 16.11.2026
- B58 – Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit: 16.11.2026
- B10 – Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, i publikuar në platformën e-Prokurimi: 18.11.2026
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: 23.11.2026

III. Dispozitat e shkelura lidhur me mosshqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim dhe anulimin e aktivitetit të prokurimit:

- Neni 108/A i LPP-së,
- Neni 62.1 i RRPP-së,
- Neni 62.2 i RRPP-së,
- Neni 63.1.1(b) i RRPP-së,
- Neni 61.1 i RRPP-së,
- Neni 62 i LPP-së,
- Neni 43.1 i RRPP-së,
- Neni 43.2 i RRPP-së,
- Neni 43.8(a) i RRPP-së,
- Neni 109 i LPP-së,
- Neni 10 i LPP-së.

VI. Kundërshtimi i vendimit të AK-së

A. Mosshqyrtimi i kërkesës për rishqyrtim

AK nuk ka trajtuar asnjërin prej pretendimeve të PBC. Në vendimin e datës **16.11.2026**, AK e arsyeton mosshqyrtimin me anulimin e aktivitetit. Në momentin e parashtrimit të kërkesës, më **12.11.2026**, aktiviteti nuk ishte anuluar. Anulimi ka ndodhur katër (4) ditë kalendarike më pas, gjatë periudhës së shqyrtimit. Pra, mungesa e pretenduar e objektit të trajtimit është krijuar nga një veprim i mëvonshëm i vetë AK-së.

Neni 108/A.6 i LPP-së dhe neni 61.3 i RRPP-së përcaktojnë shqyrtimin brenda tri ditëve të punës, me mundësi zgjatjeje të arsyetuar. PBC nuk pretendon tejkalim të këtij afati vetëm për shkak të katër ditëve kalendarike; konteston mosshqyrtimin e pretendimeve.

A.1. Rastet ligjore të refuzimit dhe ndërprerjes

Neni 108/A, paragrafi 8, i LPP-së dhe neni 62.1 i RRPP-së përcaktojnë shprehimisht rastet në të cilat AK mund ta refuzojë kërkesën për rishqyrtim. Në rastin konkret, AK nuk ka konstatuar, argumentuar apo dëshmuar përmbushjen e asnjërit prej kushteve ligjore që do ta justifikonin refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të PBC-së. Kjo dëshmohet si në vijim:

- **108/A.8.1 dhe 62.1(a)** – jashtë afatit: F02 dhe B05 provojnë respektimin e afatit fillestar.
- **108/A.8.2 dhe 62.1(b)** – objekt i papranueshëm: F02 konteston dokumentet e tenderit, objekt i lejuar sipas **108/A.1** dhe 59.1.
- **108/A.8.3 dhe 62.1(c)** – mangësi të kërkesës: AK nuk identifikon mangësi apo kërkesë për plotësim sipas **108/A.5** dhe 61.2.
- **108/A.8.4** – rishqyrtim në kuptimin e asaj që kërkon ankuesi: PBC kërkoi korrigjimin e kritereve dhe vazhdimin e procedurës, jo anulimin e aktivitetit.
- **108/A.10.1 dhe 62.1(d)** – pretendime të pabazuara: AK nuk ka vlerësuar asnjërin nga tetë pretendimet.
- **108/A.9 dhe 62.3** – tërheqja e kërkesës: PBC nuk e ka tërhequr atë.

Neni 108/A.9 dhe neni 62.2 kërkojnë arsyetimin e refuzimit. Neni 63.1.1(b), i cituar nga AK, rregullon vijimin pas refuzimit sipas nenit 62; nuk krijon shkak të pavarur refuzimi. Anulimi i mëvonshëm nuk figuron shprehimisht si shkak autonom. PBC kërkon që OSHP të vlerësojë ligjshmërinë e anulimit në masën e nevojshme për të vendosur mbi refuzimin.

B. Anulimi gjatë pezullimit të dokumentuar

Njoftimi i AK-së i datës 13.11.2026, f. 1, konfirmon shprehimisht pezullimin automatik sipas nenit 108/A.2 të LPP-së. AK citon nenin 61.1(a) të RRPP-së, që lidhet me vendimet për dhënie të kontratës; për dokumentet e tenderit zbatohet 61.1(b), në lidhje me 63.1.1(b). Ky referim i pasaktë nuk e zhbën faktin e pezullimit.

Sipas vetë arsyetimit të vendimit të 16.11.2026, anulimi i ka paraprirë refuzimit të trajtimit. PBC kërkon administrimin e gjurmës elektronike dhe të çdo akti për përfundimin e pezullimit. Nuk pretendohet se çdo anulim gjatë pezullimit është automatikisht i ndaluar, por se AK duhet të dëshmojë bazën ligjore dhe rendin e veprimeve konkrete.

C. Mungesa e arsyetimit faktik të anulimit

AK mbështetet në nenin 62.2.2 të LPP-së dhe nenin 43.8(a) të RRPP-së. Si vendimi i **16.11.2026**, f. 1, ashtu edhe B10, f. 3, IV.3 dhe V.2, përsërisin kushtet e përgjithshme ligjore, por nuk identifikojnë ngjarjen konkrete, datën, dëshmitë, arsyen pse ishte jashtë kontrollit të AK-së dhe pse nuk mund të parashikohej në inicim.

Neni 62 i LPP-së, në lidhje me nenin 10, kërkon dokumentimin e hollësishëm të bazës faktike dhe juridike të anulimit; neni 43.1 i RRPP-së kërkon paraqitjen e tyre në B58.

Kërkohet administrimi i B58 dhe i deklaratës së arsyetuar me dokumentet mbështetëse. Mungesa e arsyetimit konkret në dy aktet e disponueshme është e provuar; ekzistenca e dokumenteve të tjera duhet verifikuar.

B05, f. 7–8, IV.3.3, e cilëson projektin prioritar, të planifikuar për vitin 2026 dhe të rëndësishëm për shërbimet e tatimpaguesve, duke justifikuar shkurtimin e afatit. Kjo nuk përjashton një ngjarje të mëvonshme objektive, por e bën të domosdoshëm identifikimin e saj dhe të kohës kur ka ndodhur. Afati minimal treditor i nenit 43.8(a) nuk rezulton i shkelur në raport me afatin e zgjatur **23.11.2026**.

D. Përgatitja e parakohshme e B10

Nenet 43.1 dhe 43.2 të RRPP-së dallojnë vendimin B58 nga njoftimi përfundimtar B10. B58 publikohet menjëherë; B10 përgatitet dhe publikohet pas përfundimit të afateve të ankimit dhe shqyrtimit. B10, f. 1 dhe 3, provon se është përgatitur më **18.11.2026**, vetëm dy ditë pas vendimit të anulimit. Edhe nëse B58 është publikuar më **16.11.2026**, afati pesëditor i nenit 60.1(c) nuk kishte skaduar. Po ashtu nuk kishte skaduar afati dhjetëditor i nenit 109 për ankim kundër refuzimit të rishqyrtimit.

PBC kërkon konstatimin e mosrespektimit të rendit kohor të nenit 43.2 dhe verifikimin e datës së publikimit nga regjistri elektronik. Ky argument nuk bazohet në një ndalim të përgjithshëm dhjetëditor të vijimit të procedurës për dokumentet e tenderit; bazohet në rregullin specifik për B10.

V. Dispozitat e shkelura sipas pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të datës 12.11.2026, të cilat mbeten të pandryshuara:

- Neni 7 i LPP-së,
- Neni 9 i LPP-së,
- Neni 27 i LPP-së,
- Neni 28 i LPP-së,
- Neni 51 i LPP-së,
- Neni 52 i LPP-së,
- Neni 69 i LPP-së,
- Neni 17.12 i RRPP-së,
- Neni 19.1 i RRPP-së,
- Neni 19.4 i RRPP-së,
- Neni 25.5 i RRPP-së,
- Neni 25.6 i RRPP-së,
- Neni 25.17 i RRPP-së,
- Neni 26.9 i RRPP-së,
- Neni 27.7 i RRPP-së.

VI. Pretendimet ankimore fillestare, të cilat mbeten të pandryshuara

B05, f. 5, III.2.4, konfirmon kriteret që janë objekt i pretendimeve 1–6; B05, f. 7, IV.2, konfirmon peshat 60%, 15% dhe 25% dhe formulimin e notimit. Për pretendimet që mbështeten edhe në sqarimet dhe anekset, kërkohet administrimi i dokumenteve origjinale.

Referencat e praktikës shqyrtuese të përmendura në kërkesën fillestare duhen vlerësuar sipas teksteve të plota.

PBC mbetet pranë të gjitha pretendimeve, fakteve, argumenteve, bazave ligjore dhe kërkesave për korrigjim të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të datës 12.11.2026. Kjo kërkesë, në tërësinë e saj, përbën pjesë integrale të ankesës. Pretendimet riparaqiten më poshtë:

I. OBJEKTI I KËRKESËS

Parashtruesi nuk konteston nevojën e ATK-së që platforma fiskale të mirëmbahet dhe avancohet me standarde të larta. Kontestohet mënyra se si disa kritere janë formuluar dhe kombinuar, sepse në efektin e tyre praktik reduktojnë konkurrencën dhe krijojnë kushte që mund t'i plotësojë vetëm një Operator Ekonomik i caktuar, individualisht ose përmes një grupi/konsorciumi ku ai merr pjesë.

Pretendimet më poshtë paraqiten shkurt, secili me kriterin e kontestuar, efektin eliminues/favorizues, bazën ligjore dhe korrigjimin e kërkuar.

II. PRETENDIMET

1. Dokumenti i konfirmimit/mbështetjes nga AWS ose distributori i autorizuar

Kërkesa e kontestuar:

FDT kërkon që OE të dorëzojë dokument konfirmimi dhe mbështetjeje nga AWS ose nga një distributor i autorizuar për shërbimet AWS.

Pse favorizon / përjashton:

Kjo kërkesë është kriter eliminues. Nëse AWS ose distributori i autorizuar nuk ia lëshon dokumentin një OE-je, ai OE nuk mund ta përmbushë kriterin dhe eliminohet nga gara, pavarësisht se mund të posedojë kapacitetin teknik, profesional, përvojën në kontrata të ngjashme dhe stafin e kualifikuar për realizimin e kontratës.

Në rrethanat konkrete, ky nuk është vetëm një rrezik teorik. Parashtruesi ka tentuar ta sigurojë dokumentin dhe ka marrë përgjigje negative me arsyetimin se, për këtë projekt, mbështetja po i ofrohet një partneri tjetër. Rrjedhimisht, dokumenti nuk është realisht i qasshëm në kushte të barabarta për të gjithë OE-të e interesuar.

Kjo krijon një avantazh faktik dhe ekskluziv për OE-në që e disponon këtë mbështetje. Ai OE mund ta plotësojë kriterin individualisht ose përmes një grupi/konsorciumi ku merr pjesë, ndërsa OE-të e tjera, edhe nëse posedojnë kapacitet të plotë për realizimin e kontratës, vendosen para vetëm dy alternativave: ose të lidhen me OE-në që e ka qasjen në këtë dokument, ose të eliminohen nga gara.

Pra, pranueshmëria e ofertës nuk varet vetëm nga kapaciteti real i OE-së, por nga një dokument i kontrolluar nga një palë e tretë private, i cili në praktikë nuk u vihet në dispozicion në mënyrë të barabartë të gjithë operatorëve të interesuar. Efekti është favorizimi i një OE-je të caktuar ose i konsorciumit ku ai merr pjesë dhe eliminimi i OE-ve të tjera nga konkurrenca.

Dispozitat e shkelura:

- Neni 7.1 dhe 7.2 i LPP-së – sepse kriteri krijon trajtim të pabarabartë, redukton/eliminon konkurrencën dhe krijon avantazh për një OE të caktuar;
- Neni 51.1 i LPP-së – sepse kriteret duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për të dëshmuar kapacitetin profesional dhe teknik të OE-së;
- Neni 51.2 i LPP-së – sepse edhe dokumentet dëshmuese duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për verifikimin e kapacitetit;
- Neni 51.3 i LPP-së – sepse kriteret dhe dokumentet e kërkuara duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës;
- Neni 69.1 i LPP-së – sepse AK mund të kërkojë vetëm dëshmi relevante dhe të nevojshme për vërtetimin e aftësisë teknike dhe profesionale;
- Neni 25.17 i RRPP-së – sepse kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës;
- Neni 26.9 i RRPP-së – sepse kërkesa për autorizim/licencë arsyetohet vetëm kur natyra e shërbimit kërkon që ai të ofrohet nga operatori që posedon autorizimin përkatës, ndërsa zhvillimi, mirëmbajtja dhe avancimi i kësaj platforme nuk janë dëshmuar se mund të realizohen vetëm nga një OE që posedon dokument mbështetjeje nga AWS/distributori.

Kërkesa e Parashtruesit:

Të hiqet në tërësi kërkesa për dokument konfirmimi/mbështetjeje nga AWS ose distributori i autorizuar dhe Evidenca përkatëse nga FDT, në mënyrë që pjesëmarrja dhe kualifikimi të varen nga kapacitetet reale teknike dhe profesionale të OE-së dhe jo nga qasja në një dokument që, në rrethanat konkrete, nuk është i disponueshëm në kushte të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë.

2. Referenca prej së paku 250,000 € vetëm në AWS

Kërkesa e kontestuar:

OE duhet të dëshmojë realizimin e kontratave për "ofrimin e shërbimeve AWS" në vlerë së paku 250,000 €.

Pse favorizon / përjashton:

Kjo kërkesë është eliminues?, sepse një OE që ka realizuar kontrata të konsiderueshme dhe të krahasueshme për zhvillim, mirëmbajtje dhe avancim të sistemeve komplekse softuerike, por nuk ka kontrata të emërtuara specifikisht si "shërbime AWS" në vlerën 250,000 €, eliminohet nga gara pa u vlerësuar kapaciteti i tij real për realizimin e kontratës.

Objekti i këtij aktiviteti nuk është vetëm ofrimi i shërbimeve AWS. Ai përfshin mirëmbajtje 24/7, zhvillim dhe avancim të aplikacionit, mikroshërbime, integrime, Data Warehouse, testim, DevSecOps, siguri, optimizim dhe implementim të funksionaliteteve të reja. Prandaj, kufizimi i përvojës së kompanisë vetëm në kontrata AWS nuk pasqyron objektin real të kontratës.

Një OE mund të ketë përvojë të gjerë në zhvillimin, mirëmbajtjen dhe avancimin e platformave komplekse dhe të posedojë staf me kompetencat e nevojshme për teknologjitë

e platformës, edhe nëse kontratat e tij të mëparshme nuk kanë qenë të lidhura komercialisht me AWS. Në këtë mënyrë, kriteri favorizon OE-në që tashmë posedon pikërisht referencën financiare AWS të kërkuar, ndërsa eliminon të gjithë OE-të e tjerë me përvojë të krahasueshme, vetëm për shkak se përvoja e tyre është realizuar në teknologji apo infrastruktura të tjera.

Dispozitat e shkelura:

- Neni 7.2 dhe 7.3 i LPP-së – sepse kriteri redukton konkurrencën dhe krijon avantazh për OE-të që posedojnë pikërisht referenca AWS;
- Neni 51.3 i LPP-së – sepse kriteri duhet të jetë drejtpërdrejt relevant dhe proporcional me objektin real të kontratës;
- Neni 69.1 i LPP-së – sepse AK duhet të kërkojë vetëm dëshmi relevante dhe të nevojshme për kapacitetin teknik dhe profesional;
- Neni 69.4.2 i LPP-së – i cili kërkon dëshmimin e kontratave kryesore të rëndësishme të shërbimeve, dhe jo kontrata identike apo të kufizuara në një prodhues/teknologji të vetme;
- Nenet 25.5 dhe 25.6 të RRPP-së – sepse kërkesat minimale duhet të jenë të qarta, relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës;
- Opinioni i KRPP-së i datës 09.06.2023, Pyetja 11, sipas të cilit kërkimi i kontratave "të njëjta/identike" kufizon maksimalisht konkurrencën, ndërsa përvoja duhet të kërkohet përmes kontratave të ngjashme/relevante.

Kërkesa e Parashtruesit:

Të ndryshohet kriteri dhe të kërkohen kontrata të ngjashme/relevante për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemeve ose platformave komplekse softuerike, në vend të kufizimit vetëm në kontrata për "shërbime AWS", duke ruajtur një nivel financiar proporcional me objektin e kontratës.

3. AWS Certified Solutions Architect vetëm për dy Senior DevOps/SRE

Kërkesa e kontestuar:

Për dy Senior DevOps/SRE kërkohet detyrimisht AWS Certified Solutions Architect – Associate ose më i lartë. Pra, AK nuk kërkon certifikim specifik për pozitën DevOps/SRE, por një certifikim të orientuar për Solutions Architect, ndërsa njëkohësisht refuzon certifikime profesionale që lidhen drejtpërdrejt me funksionet DevOps/SRE.

Pse favorizon / përjashton:

Kjo kërkesë është kriter eliminues, sepse OE që nuk propozon pikërisht dy ekspertë me këtë certifikim specifik eliminohet nga gara, edhe nëse ekspertët e tij posedojnë përvojë reale dhe certifikime drejtpërdrejt të lidhura me detyrat e një Senior DevOps/SRE.

AWS Certified Solutions Architect – Associate është certifikim i orientuar në arkitekturën e zgjidhjeve AWS dhe jo certifikim specifik për pozitën DevOps/SRE. Për këto role ekzistojnë certifikime që lidhen në mënyrë më të drejtpërdrejtë me përgjegjësitë e pozitës, si:

- AWS Certified DevOps Engineer – Professional;

- AWS Certified CloudOps Engineer – Associate;
- Microsoft Certified: DevOps Engineer Expert;
- Microsoft Certified: Azure Administrator Associate;
- si dhe certifikime të tjera ekuivalente në DevOps, SRE, Cloud Operations, Kubernetes dhe Infrastructure as Code.

Këto certifikime lidhen drejtpërdrejt me funksionet që vetë AK i ndërlidh me dy Senior DevOps/SRE: CI/CD, automatizim, Infrastructure as Code, Kubernetes/EKS, networking, monitoring, high availability, scaling, security dhe disaster recovery.

Në të njëjtën kohë, Technical/Solution Architect, pra pozita për të cilën një certifikim "Solutions Architect" do të ishte natyrshëm më i lidhur, nuk ka detyrim ta posedojë këtë certifikim. Pra, AK kërkon si kriter eliminues për dy Senior DevOps/SRE një certifikim të orientuar për Solutions Architect, ndërsa refuzon certifikime që janë drejtpërdrejt të orientuara për DevOps/SRE. Kjo mospërputhje dhe insistimi i AK-së për të kërkuar pikërisht këtë certifikim, duke refuzuar certifikime që janë drejtpërdrejt të lidhura me pozitën Senior DevOps/SRE, vë në dyshim proporcionalitetin dhe objektivitetin e kriterit dhe krijon avantazh për OE-në që posedon pikërisht dy ekspertë me profilin e përcaktuar, duke eliminuar operatorët e tjerë me ekspertë profesionalisht të kualifikuar për të njëjtën pozitë.

Efekti kufizues bëhet edhe më i theksuar kur ky kriter kombinohet me kërkesën për referenca prej së paku 250,000 € vetëm në AWS dhe me dokumentin e konfirmimit/mbështetjes nga AWS ose distributori, duke krijuar njëkohësisht filtra në nivel të kompanisë, stafit dhe marrëdhënies me prodhuesin/distributorin.

Dispozitat e shkelura:

- Neni 7.2 dhe 7.3 i LPP-së – sepse kriteri redukton konkurrencën dhe krijon avantazh për OE-në që posedon pikërisht profilin e kërkuar;
- Neni 51.1 i LPP-së – sepse kriteret duhet të kufizohen vetëm në ato që janë objektivisht të nevojshme për vërtetimin e kapacitetit profesional dhe teknik;
- Neni 51.3 i LPP-së – sepse kriteri duhet të jetë drejtpërdrejt relevant dhe proporcional me përgjegjësitë konkrete të pozitës;
- Neni 69.1 i LPP-së – sepse AK mund të kërkojë vetëm dëshmi relevante dhe të nevojshme për vërtetimin e aftësisë teknike dhe profesionale;
- Nenet 25.5 dhe 25.6 të RRPP-së – sepse kriteret dhe dokumentet dëshmuese duhet të jenë të qarta, relevante dhe proporcionale dhe të mos kufizojnë konkurrencën përtej asaj që është objektivisht e nevojshme.

Kërkesa e Parashtruesit:

Të ndryshohet kriteri duke pranuar certifikime profesionale relevante dhe ekuivalente për pozitën Senior DevOps/SRE, përfshirë AWS Certified DevOps Engineer – Professional, AWS Certified CloudOps Engineer – Associate, Microsoft Certified: DevOps Engineer Expert, Azure Administrator Associate, Azure Network Engineer Associate, CKA, CKS, Terraform ose certifikime të tjera ekuivalente.

4. Diplomat e stafit – kufizim sipas drejtimit dhe nivelit akademik

Kërkesa e kontestuar:

Për shumicën e pozitave teknike FDT kërkon diplomë "Inxhinier i Kompjuterikës ose Elektroteknikës", pa përcaktuar shprehimisht pranimin e diplomës Bachelor dhe pa përfshirë drejtimet e tjera relevante ose ekuivalente.

Pse favorizon / përjashton:

Pas sqarimit të datës 10.11.2026, AK ka pranuar shprehimisht se diplomat në Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri Softuerike konsiderohen ekuivalente me Inxhinieri Kompjuterike ose Elektroteknike. Megjithatë, ky zgjerim nuk është pasqyruar qartë në formulimin e FDT-së dhe vazhdon të mbetet e pasqaruar shprehimisht çështja e nivelit Bachelor për pozitat teknike.

Problemi juridik, rrjedhimisht, nuk qëndron më te pretendimi se AK refuzon Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Softuerike, por te nevoja që kriteri eliminues të jetë i harmonizuar, i qartë dhe i lexueshëm në të njëjtën mënyrë nga çdo OE para ofertimit. FDT përdor formulimin "Inxhinier i Kompjuterikës ose Elektroteknikës", ndërsa sqarimi zgjeron drejtimet e pranueshme pa e përcaktuar shprehimisht nivelin minimal akademik.

Për këtë arsye, FDT duhet të korrigjohet në mënyrë eksplicite që të mos mbetet hapësirë interpretimi gjatë vlerësimit lidhur me emërtimin e diplomës, drejtimet ekuivalente dhe pranimin e Bachelor-it ose nivelit më të lartë në fushat relevante.

Vetë sqarimet e AK-së tregojnë nevojën për harmonizim formal të kriterit:

- në sqarimin e datës 10.11.2026, AK ka deklaruar se Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri Softuerike konsiderohen ekuivalente me Inxhinieri Kompjuterike ose Elektroteknike;
- ndërkohë, kriteri bazë në FDT vazhdon të jetë i formuluar më ngushtë dhe nuk përcakton shprehimisht nivelin Bachelor ose një listë të plotë të drejtimeve relevante/ekuivalente.

Për një kriter eliminues, standardi i zbatueshëm duhet të jetë i qartë para dorëzimit të ofertave dhe nuk duhet t'i lihet komisionit të vlerësimit të përcaktojë pas hapjes se si do të interpretohen emërtimet e diplomave dhe niveli akademik.

Praktika e OSHP-së e ka trajtuar pikërisht këtë çështje. Në OSHP nr. 645/26 dhe OSHP nr. 698/26 është trajtuar kufizimi i kandidatëve me Bachelor relevant përmes kërkesave për nivel më të lartë akademik ose tituj të sistemit të vjetër universitar. Në këto raste është vlerësuar se, në mungesë të një detyre konkrete që nuk mund të realizohet nga një profesionist me Bachelor relevant dhe përvojën e kërkuar, një kufizim i tillë nuk është i arsyetuar dhe duhet të mundësohet pranimi i diplomës Bachelor në fushat relevante/ekuivalente.

Në këtë aktivitet AK nuk ka identifikuar ndonjë detyrë konkrete për pozitat e kontestuara që do të ishte objektivisht e pamundur të realizohej nga një ekspert me Bachelor relevant dhe përvojën profesionale të kërkuar. Për rrjedhojë, kërkohet jo heqja e kërkesës për arsim

relevant, por harmonizimi i FDT-së me sqarimin e AK-së dhe përcaktimi i qartë se Bachelor ose nivel më i lartë në fushat relevante/ekuivalente pranohet për pozitat përkatëse.

Dispozitat e shkelura:

- Neni 7.2 dhe 7.3 i LPP-së – sepse kriteri redukton konkurrencën dhe krijon trajtim të pabarabartë;
- Neni 27.1 i LPP-së – sepse kriteret dhe kushtet e procedurës duhet të jenë të përcaktuara qartë në Dosjen e Tenderit;
- Neni 51.1, 51.2 dhe 51.3 i LPP-së – sepse kriteret dhe dëshmitë duhet të kufizohen në ato që janë të nevojshme, relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës;
- Neni 69.1 i LPP-së – sepse AK mund të kërkojë vetëm dëshmi relevante dhe të nevojshme për vërtetimin e aftësisë teknike dhe profesionale;
- Nenet 25.5 dhe 25.17 të RRPP-së – sepse kriteret minimale duhet të jenë të qarta, drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa e Parashtruesit:

Të korrigjohet FDT-ja dhe të përcaktohet shprehimisht se pranohen Bachelor ose nivel më i lartë në Inxhinieri Kompjuterike, Shkenca Kompjuterike, Inxhinieri Softuerike, Informatikë, Teknologji Informative, Elektroteknikë ose fushë tjetër relevante/ekuivalente me pozitën përkatëse, së bashku me përvojën profesionale të kërkuar.

5. Technical Architect / Solution Architect – "sisteme të mëdha" dhe referencë pa kritere të përcaktuara

Kërkesa e kontestuar:

Për pozitën Technical Architect / Solution Architect, FDT kërkon "përvojën me sisteme të mëdha me dëshmi me referencë", pa përcaktuar se çfarë konsiderohet "sistem i madh", sa përvojë minimale kërkohet dhe as nga kush duhet të lëshohet referenca.

Pse favorizon / përjashton:

Kjo është kërkesë eliminatore, por nuk përmban parametrat minimalë mbi të cilët një OE mund të përcaktojë paraprakisht nëse eksperti i propozuar e plotëson kriterin. AK nuk ka përcaktuar:

- numrin minimal të përdoruesve apo transaksioneve;
- numrin e moduleve, mikroshërbimeve apo integrimeve;
- vlerën minimale të projektit;
- nivelin e HA/DR, scalability apo kompleksitetit arkitekturor;
- numrin minimal të projekteve;
- vitet minimale të përvojës;
- kohëzgjatjen minimale të angazhimit të ekspertit;
- kush duhet ta lëshojë referencën: klienti/autoriteti kontraktues, punëdhënësi apo një palë tjetër;
- çfarë përmbajtjeje minimale duhet të ketë referenca dhe çfarë elementi duhet të dëshmojë për ta konsideruar sistemin "të madh".

Madje, AK në sqarime ka deklaruar se për rolet "Senior" preferohen së paku 5 vite përvojë, por njëkohësisht ka pranuar se kjo nuk përbën kriter eliminues, sepse Dosja e Tenderit nuk përcakton shprehimisht një minimum të tillë. Në këto rrethana, një OE nuk mund ta dijë para dorëzimit të ofertës as nëse projekti i ekspertit do të konsiderohet "sistem i madh", as nëse dokumenti i paraqitur do të konsiderohet referencë e pranueshme. Nëse komisioni pas hapjes së ofertave vendos se sistemi nuk është "i madh", ose se referenca duhej të ishte lëshuar nga një subjekt i caktuar apo të përmbante elemente që FDT nuk i ka kërkuar paraprakisht, eksperti dhe rrjedhimisht oferta mund të eliminohen mbi bazën e një standardi që nuk ka qenë i përcaktuar para ofertimit. Kjo i jep komisionit diskrecion që, vetëm pas hapjes së ofertave, të përcaktojë:

çfarë është "sistem i madh", sa përvojë është e mjaftueshme, kush duhet ta lëshojë referencën dhe çfarë duhet të përmbajë ajo. Një kriter eliminues duhet të jetë i përcaktuar paraprakisht dhe të funksionojë si test objektiv "plotëson / nuk plotëson", dhe jo të krijohet apo plotësohet përmes interpretimit të komisionit pas hapjes së ofertave.

Dispozitat e shkelura:

- Neni 7.2 dhe 7.3 i LPP-së – sepse kriteri i padefinuar krijon mundësi për trajtim të pabarabartë dhe aplikim selektiv;
- Neni 27.1 i LPP-së – sepse kushtet dhe kriteret materiale duhet të përcaktohen qartë në Dosjen e Tenderit;
- Neni 51.1 dhe 51.2 i LPP-së – sepse kriteret dhe dokumentet mbi të cilat bëhet kualifikimi duhet të përcaktohen paraprakisht dhe qartë;
- Neni 51.3 i LPP-së – sepse kriteret duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale;
- Neni 69.1 i LPP-së – sepse dëshmitë për kapacitetin teknik/profesional duhet të jenë relevante dhe të nevojshme;
- Nenet 25.5 dhe 25.17 të RRPP-së – sepse kriteret dhe dokumentet dëshmuese duhet të jenë të qarta, relevante dhe proporcionale.

Kërkesa e Parashtruesit:

Të korrigjohet FDT-ja duke definuar "sistemin e madh" me parametra objektivë dhe të matshëm, minimumin e përvojës dhe numrin/natyrën e projekteve, si dhe të përcaktohet qartë nga kush duhet të lëshohet referenca, çfarë përmbajtjeje minimale duhet të ketë dhe çfarë duhet të dëshmojë, në mënyrë që kriteri të jetë i njëjtë dhe objektivisht i verifikueshëm për të gjithë OE-të.

6. Tre Senior Software Developers – kufizim vetëm në Golang dhe përvojë e pamatshme

Kërkesa e kontestuar:

Për tre Senior Software Developers, FDT kërkon përvojë në Golang, Ruby on Rails dhe .NET, ndërsa AK ka sqaruar se secili nga tre zhvilluesit duhet të ketë detyrimisht përvojë në Golang, pa pranuar si zëvendësim përvojën në gjuhë programuese ose teknologji ekuivalente.

Pse favorizon / përjashton:

Parashtruesi nuk konteston se Golang përdoret në sistemin ekzistues. Megjithatë, kërkesa që secili nga tre Senior Software Developers të ketë patjetër përvojë në Golang është kufizuese, sepse përjashton ekspertë seniorë me përvojë të konsiderueshme në zhvillimin e sistemeve komplekse me gjuhë programuese dhe framework-e të krahasueshme, vetëm për faktin se përvoja e tyre nuk është realizuar pikërisht në Golang. Në këtë mënyrë, kriteri nuk vlerëson kompetencën reale të ekspertit në zhvillim softuerik, arkitekturë, mikroshërbime, sisteme të shpërndara dhe integrime, por e lidh pranueshmërinë me një gjuhë të vetme programuese. Problemi bëhet edhe më i theksuar sepse AK, përveçse e kufizon kriterin në Golang, nuk ka përcaktuar fare sa përvojë në Golang kërkohet.

Nuk përcaktohet:

- sa vite përvojë duhet të ketë eksperti në Golang;
- sa projekte duhet të ketë realizuar;
- çfarë roli duhet të ketë pasur;
- sa duhet të ketë qenë kohëzgjatja e angazhimit;
- çfarë kompleksiteti duhet të kenë pasur projektet;
- apo sa aktuale duhet të jetë përvoja.

Pra, kriteri është njëkohësisht tepër i ngushtë dhe i pamatshëm: përjashton ekspertët me përvojë ekuivalente, ndërsa për ekspertët që kanë përdorur Golang nuk përcakton as nivelin minimal të përvojës që duhet të dëshmojnë.

Për rrjedhojë, një ekspert me shumë vite përvojë në zhvillimin e sistemeve komplekse në gjuhë të tjera relevante mund të eliminohet, ndërsa një ekspert që ka përdorur Golang vetëm në një angazhim të shkurtër mund të konsiderohet formalisht se e plotëson kriterin. Kjo krijon kufizim të panevojshëm të konkurrencës dhe i jep komisionit hapësirë diskrecionale për të vendosur pas hapjes së ofertave se çfarë niveli përvoje në Golang konsiderohet i mjaftueshëm.

Kërkesa e Parashtruesit:

Të korrigjohet kriteri duke lejuar përvojë në gjuhë programuese dhe teknologji ekuivalente, të kombinuar me përvojë relevante në zhvillimin e sistemeve komplekse, dhe njëkohësisht të përcaktohen qartë pragjet minimale të përvojës për kompetencat që AK i konsideron të domosdoshme.

7. Scope-i dhe informacioni teknik – avantazh informativ për subjektin që e njeh sistemin

Kërkesa e kontestuar:

Pjesë materiale të gjendjes teknike të sistemit, inventarit, konfigurimeve, varësive, madhësive të resurseve, kodit burimor dhe baseline-it teknik nuk u vihen në dispozicion ofertuesve para ofertimit, por do të konfirmohen ose dorëzohen vetëm gjatë fazës së tranzicionit. Njëkohësisht, për një pjesë të avancimeve kërkohen çmime fikse edhe pse përmbajtja dhe vëllimi i detajuar përcaktohen pas analizës fillestare.

Pse favorizon / përjashton:

Vetë AK ka konfirmuar se platforma aktualisht operohet dhe mirëmbahet nga i njëjti ekip që e ka zhvilluar, në bashkëpunim me stafin e IT-së së AK-së. Në të njëjtën kohë, AK ka deklaruar se dokumentacioni i detajuar teknik, konfigurimet e infrastrukturës, kodi burimor, varësitë dhe informacionet operative të caktuara nuk do t'u jepen ofertuesve para dorëzimit të ofertave, por vetëm OE-së së kontraktuar gjatë tranzicionit. Kjo krijon një asimetri të drejtpërdrejtë informative: subjekti ose ekipi që aktualisht e operon dhe e mirëmban sistemin i njeh paraprakisht kodin, arkitekturën reale, konfigurimet, varësitë, problemet ekzistuese, çështjet e hapura, vëllimin real të punës dhe gjendjen teknike të platformës, ndërsa OE-të e tjera duhet të përgatisin ofertën dhe çmimet pa këto informacione. Pra, OE-të nuk ofertojnë mbi të njëjtën bazë informative. Ky avantazh bëhet edhe më i rëndësishëm sepse OE-ve u kërkohet të marrin përsipër mirëmbajtjen, SLA-të dhe avancimet e sistemit dhe të paraqesin çmime fikse, ndërsa një pjesë e scope-it teknik do të konstatohet vetëm pas kontraktimit. Në këto rrethana, operatori/ekipi që e njeh sistemin mund të vlerësojë shumë më saktë rrezikun, ngarkesën dhe koston reale të kontratës, ndërsa OE-të e tjera detyrohen ose të përfshijnë risk të panjohur në çmim, ose të ofertojnë nën pasiguri teknike. Kjo jo vetëm që cenon trajtimin e barabartë, por dëmton edhe krahasueshmërinë reale të ofertave, sepse çmimet nuk janë formuar mbi të njëjtin nivel informacioni. Për më tepër, lënia e inventarit, baseline-it, varësive dhe vëllimit të avancimeve për t'u përcaktuar gjatë implementimit është trajtuar edhe në praktikën e OSHP-së. Në OSHP nr. 2025/0780, është konstatuar se mungesa e kërkesave funksionale dhe ekzekutive, parametrave të avancimeve dhe kufijve të punës nuk u mundëson OE-ve të kalkulojnë çmime mbi punë reale; OSHP e aprovoi ankesën dhe kërkoi përmirësimin e Dosjes së Tenderit. Në OSHP nr. 2025/1198, është konstatuar përsëri se lënia e parametrave dhe vëllimit të punëve për t'u përcaktuar gjatë implementimit e mban objektin e kontratës të papërcaktuar në vëllim dhe kompleksitet dhe kërkon specifikime minimale dhe kufij të qartë. Në rastin konkret, problemi është edhe më serioz sepse një pjesëmarrës potencial e njeh tashmë sistemin nga operimi dhe mirëmbajtja aktuale, ndërsa operatorët e tjerë nuk kanë qasje në të njëjtin informacion para ofertimit.

Dispozitat e shkelura:

Neni 7.1, 7.2 dhe 7.3 i LPP-së – sepse OE-të duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe nuk duhet të krijohet avantazh konkurrues për një subjekt që posedon informacione materiale të paarritshme për të tjerët;

- Neni 9.1 i LPP-së – sepse AK duhet të përcaktojë llojin, përmasat dhe specifikimet funksionale të nevojës para inicimit dhe ofertimit;
- Neni 27.1 i LPP-së – sepse Dosja e Tenderit duhet të përmbajë informatat relevante, kushtet materiale dhe specifikimet e nevojshme për përgatitjen e ofertës;
- Neni 28.1 dhe 28.2 i LPP-së – sepse specifikimet teknike duhet të lidhen qartë me objektin dhe kërkesat reale të kontratës;
- Neni 28.8 i LPP-së – sepse kërkesat funksionale dhe ekzekutuese duhet të jenë mjaftueshëm të sakta që tenderuesit të mund ta përcaktojnë objektin e kontratës dhe të përgatisin ofertë të krahasueshme;

- Nenet 17.12, 19.1 dhe 19.4 të RRPP-së – sepse Termat e Referencës dhe specifikimet duhet të përshkruajnë qartë, saktë dhe në mënyrë të mjaftueshme fushëveprimin dhe rezultatet e kërkuara.

Kërkesa e Parashtruesit:

Të publikohet para ofertimit një baseline teknik minimal, i njëjtë për të gjithë OE-të, që përmban së paku inventarin relevant të komponentëve, mikroshërbimeve, varësive, gjendjen e dokumentacionit, parametrat kryesorë të resurseve dhe kufijtë e punëve/avancimeve që duhet të çmohen. Kur informacioni është konfidencial, AK mund ta mundësojë qasjen në kushte të barabarta për të gjithë ofertuesit përmes NDA/data room ose mekanizmi tjetër të kontrolluar, por nuk mund të kërkojë çmime fikse nga OE-të duke ua lënë informacionin material vetëm për fazën pas kontraktimit.

8. Kriteret e dhënies – 40% e pikëve teknike pa metodologji objektive dhe të matshme

Kërkesa e kontestuar:

Aneksi 6 përcakton:

- 15% për metodologjinë e punës dhe qasjen ndaj sfidave të AK-së; dhe
- 25% për propozimin teknik/arkitekturor, përfshirë arkitekturën, diagramet sekuenciale, integrimin me Data Warehouse dhe analizën e rrezikut.

Për të dy kriteret përcaktohet vetëm se pikët i merr oferta me "karakteristikat më të mira" dhe se pikët llogariten "proporcionalisht (me nota)".

Pse favorizon / përjashton:

Këto dy kritere përbëjnë së bashku 40% të rezultatit përfundimtar, por DT nuk përcakton metodologjinë objektive mbi të cilën do të jepen këto 40 pikë. Nuk përcaktohet:

- cilat janë nënkriteret konkrete;
- sa pikë ka secili nënkriter;
- çfarë konsiderohet metodologji "më e mirë";
- çfarë elementesh të arkitekturës vlerësohen dhe me sa pikë;
- çfarë rezultati meriton 100, 80, 60 apo 40 pikë;
- shkalla e notimit;
- mënyra e agregimit të vlerësimeve të anëtarëve të komisionit;
- apo standardi objektiv sipas të cilit dy oferta teknike krahasohen mes tyre.

Aneksi 6 jep formulën proporcionale dhe përdor vlerat Ct/Qt si pikët e karakteristikave të ofertës, por nuk përcakton se si komisioni i krijon fillimisht këto nota Ct/Qt. Pra, formula matematike nuk e bën kriterin objektiv: ajo vetëm përpunon një notë fillestare që nuk ka metodologji të përcaktuar paraprakisht. Në këto kushte, komisioni mund të vendosë vetëm pas hapjes së ofertave se çfarë konsideron "karakteristikë më të mirë", sa vlen secili element dhe çfarë note meriton secila ofertë. Kjo krijon hapësirë jashtëzakonisht të madhe diskrecionale, sepse 40% e rezultatit të përgjithshëm mund të përcaktohet mbi bazën e një vlerësimi për të cilin tenderuesit nuk e dinë paraprakisht standardin e pikëzimit. Efekti është veçanërisht i rëndë në këtë procedurë: edhe nëse disa OE i kalojnë të gjitha kriteret eliminuese, një OE i caktuar mund të marrë avantazh vendimtar përmes këtyre 40 pikëve

teknike, pa qenë e mundur që tenderuesit të verifikojnë paraprakisht apo më pas në mënyrë objektive pse një metodologji apo arkitekturë ka marrë më shumë pikë se një tjetër. Ky rrezik rritet edhe më tej kur merret parasysh se subjekti/ekipi që aktualisht e njeh dhe e operon sistemin ka njohuri paraprake më të detajuara mbi arkitekturën, problemet dhe nevojat reale të platformës, ndërsa pikërisht metodologjia, qasja dhe arkitektura përbëjnë 40% të pikëve. Për rrjedhojë, kriteri jo vetëm që është i pamatshëm, por në rrethanat konkrete krijon mekanizëm për favorizim në fazën e dhënies së kontratës, edhe nëse OE-të e tjera nuk janë eliminuar më herët nga kriteret e kualifikimit.

Dispozitat e shkelura:

- Neni 7.1–7.3 i LPP-së – sepse vlerësimi duhet të sigurojë trajtim të barabartë dhe të mos krijojë mundësi për favorizim ose diskriminim;
- Neni 52.2 i LPP-së – sepse kriteret dhe peshat duhet të përcaktohen paraprakisht dhe, sa më shumë që është e mundshme, në mënyrë objektive dhe kuantitative;
- Neni 52.3 i LPP-së – sepse për vlerësim mund të përdoren vetëm kriteret e matshme dhe të përcaktuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit;
- Neni 27.7 i RRPP-së – sepse të gjitha kriteret e tenderit ekonomikisht më të favorshëm duhet të deklarohen paraprakisht në mënyrë objektive dhe të matshme, së bashku me peshat e tyre, dhe nuk mund të krijohen ose ndryshohen gjatë procesit të vlerësimit.

Kërkesa e Parashtruesit:

Të korrigjohet Aneksi 6 dhe, para dorëzimit të ofertave, të publikohet një matricë e plotë dhe objektive e pikëzimit për kriteret 15% dhe 25%, ku të përcaktohen:

nënkriteret;

- pesha/pikët e secilit nënkriter;
- shkalla e notimit;
- kushtet konkrete për secilin nivel pikësh;
- mënyra e llogaritjes së notës Ct/Qt;
- dhe formula përfundimtare e pikëzimit.

Nëse këto elemente nuk mund të përcaktohen objektivisht dhe paraprakisht, kriteret duhet të zëvendësohen me kritere të matshme dhe të verifikueshme, në pajtim me Nenin 52 të LPP-së dhe Nenin 27.7 të RRPP-së.

III. EFEKTI KUMULATIV – KRIJIMI I NJË PROFILI QË FAVORIZON NJË OE TË CAKTUAR

Pretendimet e mësipërme nuk mund të shqyrtohen të izoluara. Problemi nuk qëndron vetëm në një kriter të veçantë, por në kombinimin e tyre, i cili krijon një profil jashtëzakonisht specifik të OE-së dhe stafit që mund të marrë pjesë në këtë procedurë.

Konkretisht:

1. në nivel të OE-së, kërkohen referenca prej së paku 250,000 € vetëm për shërbime AWS, duke mos pranuar përvojën në kontrata të ngjashme për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemeve komplekse;

2. në nivel të marrëdhënies me prodhuesin/distributorin, kërkohet dokument konfirmimi/mbështetjeje nga AWS ose distributori, pa të cilin OE eliminohet, edhe nëse posedon kapacitet të plotë teknik dhe profesional;
3. në nivel të stafit, për dy Senior DevOps/SRE kërkohet pikërisht AWS Certified Solutions Architect – Associate ose më i lartë, ndonëse ky nuk është certifikim specifik për pozitën DevOps/SRE, ndërsa AK nuk pranon certifikime profesionale që lidhen drejtpërdrejt me vetë pozitën;
4. për shumicën e stafit teknik kërkohet "Inxhinier i Kompjuterikës ose Elektroteknikës", duke krijuar kufizim si në drejtimin e studimeve ashtu edhe në nivelin akademik dhe duke mos pranuar qartë Bachelor-in në drejtime relevante/ekuivalente;
5. për Technical/Solution Architect kërkohet përvojë në "sisteme të mëdha", pa definuar se çfarë është sistem i madh, sa përvojë kërkohet dhe as nga kush duhet të lëshohet referenca;
6. për tre Senior Software Developers, secilit i kërkohet detyrimisht përvojë në Golang, pa pranuar përvojë ekuivalente dhe pa përcaktuar sa vite, sa projekte apo çfarë niveli përvoje në Golang është i mjaftueshëm;
7. OE-të duhet të formojnë çmime për mirëmbajtje dhe avancime pa pasur para ofertimit të njëjtin nivel informacioni mbi kodin, konfigurimet, varësitë, resurset dhe gjendjen reale të sistemit, ndërsa vetë AK ka konfirmuar se sistemi aktualisht operohet dhe mirëmbahet nga i njëjti ekip që e ka zhvilluar;
8. edhe pasi OE-të t'i kalojnë këto kritere eliminuese, 40% e rezultatit përfundimtar përcaktohet përmes metodologjisë dhe propozimit teknik/arkitekturor, pa matricë të detajuar dhe të matshme të pikëzimit.

Pra, filtrat vendosen njëri mbi tjetrin: kompania duhet të ketë profilin e caktuar AWS; stafi duhet të ketë diploma dhe certifikime të caktuara; një palë e tretë duhet t'i japë dokumentin e mbështetjes; ekspertët duhet të kenë profile specifike të papërcaktuara qartë; ndërsa në fund 40% e pikëve mbetet pa metodologji objektive të paracaktuar. Në këto rrethana, procedura mund të jetë formalisht e hapur, por efekti i saj material është që vetëm një OE i caktuar – individualisht ose përmes një grupi/konsorciumi ku ai merr pjesë – mund të jetë në pozitë për t'i përmbushur të gjithë këta filtra dhe njëkohësisht të ketë avantazh informativ dhe vlerësues në fazën e dhënies së kontratës. OE-të e tjera nuk përjashtohen domosdoshmërisht sepse nuk kanë kapacitet për realizimin e projektit, por sepse nuk posedojnë pikërisht kombinimin e kërkuar të referencave, autorizimit/mbështetjes, certifikimeve, diplomave dhe profileve të stafit, ose sepse kriteret janë formuluar në mënyrë që nuk lejojnë ekuivalencë apo nuk kanë prag objektiv të matshëm. Ky është pikërisht efekti që Neni 7 i LPP-së synon ta parandalojë: reduktimin ose eliminimin e konkurrencës dhe krijimin e avantazhit për një ose më shumë operatorë ekonomikë përmes mënyrës së formulimit ose zbatimit të kushteve të aktivitetit të prokurimit. Efekti kumulativ duhet të vlerësohet gjithashtu në raport me Nenet 27, 28, 51, 52 dhe 69 të LPP-së, sepse kriteret, specifikimet, dëshmitë dhe metodologjia e vlerësimit duhet të jenë të qarta, të nevojshme, relevante, proporcionale, objektive dhe të matshme.

IV. KËRKESAT PËR KORRIGJIM

Duke u bazuar në pretendimet e mësipërme, Parashtruesi kërkon nga AK-ja:

1. Të hiqet në tërësi kërkesa për dokument konfirmimi/mbështetjeje nga AWS ose distributori i autorizuar, si dhe evidenca përkatëse, si kriter eliminues.
2. Kërkesa për referenca prej 250,000 € vetëm në AWS të riformulohet në kontrata relevante/të ngjashme për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemeve ose platformave komplekse softuerike, pa u kufizuar në një prodhues të vetëm.
3. Për dy Senior DevOps/SRE të pranohen certifikime profesionale relevante dhe ekuivalente për pozitën, përfshirë AWS DevOps Engineer, AWS CloudOps Engineer, Microsoft DevOps Engineer Expert, CKA, CKS, Terraform ose ekuivalente, të kombinuara me përvojën relevante të ekspertit.
4. Për pozitat teknike të përcaktohet shprehimisht pranimi i Bachelor ose nivel më të lartë në Inxhinieri Kompjuterike, Shkenca Kompjuterike, Inxhinieri Softuerike, Informatikë, Teknologji Informative, Elektroteknikë ose fushë tjetër relevante/ekuivalente.
5. Për Technical/Solution Architect, të definohet objektivisht termi "sistem i madh", minimumi i përvojës, numri/natyra e projekteve dhe të përcaktohet qartë kush mund ta lëshojë referencën dhe çfarë duhet të përmbajë ajo.
6. Për tre Senior Software Developers, të përcaktohen pragje objektive të përvojës dhe të lejohet përvoja relevante/ekuivalente, pa e kufizuar pranueshmërinë e secilit ekspert vetëm në një gjuhë programuese të caktuar pa prag minimal të përcaktuar.
7. Të publikohet para ofertimit një baseline teknik minimal dhe i njëjtë për të gjithë OE-të, duke përfshirë informacionin e nevojshëm për dimensionimin e scope-it dhe formimin e çmimit. Për informacionin konfidencial të përdoret, sipas nevojës, NDA/data room ose mekanizëm tjetër që garanton qasje të barabartë.
8. Për kriteret 15% dhe 25% të Aneksit 6 të publikohet një matricë e plotë dhe objektive e pikëzimit, me nënkritere, peshën e secilit element, shkallën e notimit, mënyrën e llogaritjes së Ct/Qt dhe kushtet konkrete për secilin nivel pikësh.
9. Pas korrigjimit të Dosjes së Tenderit dhe sqarimit të kritereve, të bëhet zgjatja e afatit për dorëzimin e ofertave, në mënyrë që të gjithë OE-të e interesuar të kenë kohë të mjaftueshme për të përgatitur oferta në bazë të kushteve të korrigjuara dhe të njëjta.

IX. Kërkesa përfundimtare drejtuar OSHP-së

Duke u bazuar në faktet, argumentet, dëshmitë dhe dispozitat ligjore të paraqitura në këtë ankesë, PBC SH.P.K. kërkon nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që, në kuadër të kompetencave të përcaktuara me LPP-në, të nxjerrë këtë:

VENDIM

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik PBC SH.P.K.

II. ANULOHET vendimi i Autoritetit Kontraktues – Administratës Tatimore të Kosovës, i datës 16.11.2026, për refuzimin e trajtimit të kërkesës për rishqyrtim të datës 12.11.2026.

III. KONSTATOHET se Autoriteti Kontraktues nuk ka shqyrtuar në përmbajtje pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe nuk ka arsyetuar refuzimin e saj në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe RRPP-së.

IV. ANULOHET vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit, i datës 16.11.2026 (B58), si dhe njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit (B10), i publikuar më 18.11.2026, dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në fazën paraprake të anulimit.

V. SHQYRTOHEN të gjitha tetë pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të datës 12.11.2026, të cilat mbeten të pandryshuara në këtë ankesë, duke vlerësuar secilin pretendim individualisht dhe efektin e tyre kumulativ.

VI. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues që të korrigjojë Dosjen e Tenderit, Fletën e të Dhënave të Tenderit, specifikimet teknike dhe kriteret për dhënien e kontratës, në përputhje me dispozitat e LPP-së, RRPP-së dhe konstatimet e Panelit Shqyrtues.

VII. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues që, pas korrigjimit dhe publikimit të dokumentacionit të tenderit, të përcaktojë një afat të ri dhe të mjaftueshëm për dorëzimin e ofertave.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale dhe jomateriale do të përcaktohen pas kryerjes së një ekspertize financiare.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*